



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN KOORDINIMIT DHE INFORMIMIT PUBLIK
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1211 Prot.

12

Patos, më 19/01/2022

PROCES-VERBAL

I mbajtur sot në datë 18.01.2022 ora 10:00 në Njësinë Administrative Ruzhdie ora 10:00, fshati Gjinoqarë, ku organizohet seanca dëgimore e Këshillit të Bashkisë lidhur mbi "Diskutimin e Rregullores së Konsultimit për Këshillin Bashkiak"

Pjesëmarrës në këtë mbledhje janë:

1. Anëtarë të Këshillit Bashkiak
2. Sekretari i Këshillit
3. Kryetar të fshatrave të Njësisë Ruzhdie
4. Banorë të zonës dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile

Takimi hapet nga Këshilltari Albion Ballaxhia

Albion Ballaxhia – më lejoni që në radhë të parë t'ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim i cili është i pari për vitin 2022 dhe ka të bëjë mbi diskutimin e Rregullores së Konsultimeve Publike të Këshillit të Bashkisë, konsultime publike të cilat ai duhet të realizojet gjatë një viti. Për më tepër Sekretari i Këshillit do t'ju japi detajet mbi këtë rregollore.

Balil Balili – Ky model rregullore është hartuar në kuadër të projektit Bashkit të Forta, i zbatuar nga Helvetas dhe i financuar nga Qeveria Zvicerane e cila ka një marreveshje me Bashkine Patos dhe kjo rregullore përcakton qartë rregullat dhe procedurat e këshillimit me publikun duke siguruar transparencën e politikëbërjes dhe vendimmarrjes të akteve që miraton Këshilli i Bashkisë. Pra për cdo vendim të rëndësishëm kjo rregullore na detyron të térheqim mendimin tuaj me qëllim që cdo vendimmarrje e Këshillit Bashkiak të jetë në përputhje me ligjet dhe në interes të qytetarëve. Gjithashtu dua ate theksoj se kjo rregullore është e publikuar edhe në faqen e Këshillit dhe deri në ditën kur do të zhvillohet mbledhja ne presim komentet apo syjetimet tuaja. Fjala është për ju.

Nuri Gllava (Kryetar i fshatit Gjinoqarë) – unë e kam parë maretialin e rregullores së konsultimit dhe mendoj se është një dokumet i hartuar i mirë dhe i plotë nga ana e hartuesve të tij.

Albion Ballaxhia – ajo që unë doja të vija theksin është se kjo rregullore na detyron ne si Këshill që për vendimet që ne duhet të marrim duhet me patjetër të që ne të garantojmë pjesëmarrjen aktive të publikut në proçesin e hartimit dhe rishikimit të politikave, akteve, rregulloreve dhe vendimmarje të tjera të Këshillit Bashkiak.

Shaban Lazaj (Kryetari i fshtit Drenie) – në gjykimin tim kjo rregullore është plotë dhe mendoj se miratimi i saj do të plotësojë kadrin ligjor të marrëdhënies komunitet këshill.

Balil Balili – Bashkia dhe Këshilli cdo vit i ka realizuar këto takime me komunitetin edhe pa ketë rregullore pasi është një detyrim ligjor që ne të marrim mendimet dhe sygjerimet tuaja përpara cdo vendimi. Gjithsesi kjo rregullore është e publikuar edhe në faqen e bashkisë dhe ne jemi akoma kohe për të marr cdo sygjerim tuajin.

Albion Ballaxhia – sic e tha edhe Balili ne jemi në pritje të mendimeve tuaja. Nëse nuk eni gjë tjetër për të shtuar unë ju falenderoj edhe një herë për pjesëmarrjen tuaj dhe padyshim që do të shihemi në takime të tjera.

**Koordinator
Për Konsultimin Publik
Suzana Hysenaj**

